



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS

Adresa : Lagja “Naftetari”, Rruga “Unaza”

Nr. ____ Prot.

Patos me, ____/____/2016

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESI

Data ____/____/2016

Për: Shoqerine “ ED KONSTRUKSION”sh.p.k Tirane ne kontrate bashkepunimi me
 &“FUSHA” sh.p.k Tiarne & “ARKONSTUDIO” sh.p.k Tirane

* * *

Procedura e prokurimit: Tender i Hapur

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikualifikim Urban i Shëtitores Republika”** Bashkia Patos

Kohezgjatja e kontrates eshte :**8 muaj nga nenshkrimi i kontrates**

1.Fondi limit: **82,179,206 (tetedhjetë e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e nente mijë e dyqind e gjashtë) lekë**, venë në dispozicion Fondi i Zhvillimit te Rajoneve, për objektin **“Rikualifikim Urban i Shëtitores Republika”**.

2.Burimi i financimit: Buxheti i shtetit ☐ Te ardhurat e Bashkise ☐ Grant ☐

Fondi i Zhvillimit te Rajoneve X

Investim X Shpenzim operativ ☐

3.Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: **26/05/2016 ora 11:00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

- “ALKO IMPEX General Construcion” dege e shoqerise se huaj Tirane me nr. NIPT K91326028I ofron vleren sipas preventivit 69,105,600 (gjashtedhjetë e nente milion e njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH.
- Shoqeria “B-93” shpk Fier me nr. NIPT J62903508R ofron vleren sipas preventivit 73,092,159 (shtatëdhjetë e tre milion e nentëdhjetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e nente) leke pa TVSH.
- Shoqeria “COMPANY RIVIERA 2008” shpk Kamez, Tirane me nr. NIPT K81716011V ofron vleren sipas preventivit 73,361,842 (shtatëdhjetë e tre milion e treqind e gjashtedhjetë e një mijë e tetëqind e dyzetë e dy) leke pa TVSH.
- Shoqeria “ED KONSTRUKSION”sh.p.k Tirane me nr.Nipti K61625001I &“FUSHA” sh.p.k Tirane me nr.Nipt-i J61922018S & “ARKONSTUDIO” sh.p.k Tirane me nr.Nipt-i

L42019004I ofron vleren sipas preventivit 80,238,055 (*tetëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e tete mijë e pesëdhjetë e pese*) leke pa TVSH.

Jane s'kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. *ALKO IMPEX General Construcion dege e shoqerise se huaj*

2. *"B-93" shpk*

3. *COMPANY RIVIERA 2008"shpk & "VLLAZNIA" sh.p.k*

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

1) Shoqeria "ALKO IMPEX General Construcion" dege e shoqerise se huaj Tirane kishte mangësi të dokumentave ligjore.

Mangësitë në dokumentacion te "ALKO IMPEX General Construcion" dege e shoqerise se huaj Tirane, janë si më poshtë:

- Nuk ploteson kriterin e vecante te kualifikimit vertetim te gjendjes financiare nga nje banke .
- Nuk ploteson kriterin mbi Inxhinierin e Certifikuar per Eficencen e Energjise pasi nuk ka paraqitur nje te tille.
- Nuk ploteson kriterin mbi punonjesit: 2 punonjes saldator, 2 punonjes elektricist, 2 punonjes hidraulik, 2 punonjes muratore pasi nuk ka deshmi kualifikimi nga IQT-ja dhe as ekuivalente te saj. Ne dokumentacionin e paraqitur eshte vetem nje deklarate e cila nuk verteton se kush nga punonjesit e paraqitur ne kete deklarate jane punonjes sipas kerkeses se siperpermendur dhe nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion tjeter per te vertetuar kete fakt.
- Nuk ploteson kriterin mbi mjetin *Makina transporti vetshkarkuese 10-20ton* nga 3 te kerkuar ka vetem 2 cope (mjeti tjeter i paraqitur eshte vetem nje koke terheqese).

2) Shoqeria "B-93" shpk Fier sh.p.k kishte mangësi të dokumentave ligjore.

Mangësitë në dokumentacion te "B-93" shpk Fier, janë si më poshtë:

- Nuk ploteson kriterin mbi punen e ngjashme pasi puna e paraqitura per kete procedure nuk klasifikohet tek pune te ngjashme per nje objekt te vetem pika a) si dhe nuk ploteson as piken b) pasi vlere monetare totale e puneve te kryera nuk e arrin vleren 164 358 412 leke (*dyfishi i vleres limit*).
(*Nje pjese e anetareve te komisionit te vleresimit te ofertave ka shkuar ne terren per te verifikuar punen e ngjashme te paraqitur nga operatori "Projekt pilot per integrimin e zones informale ne lagjen Kushtrimi" Vlore, ku eshte vertetuar qe kjo nuk eshte pune e ngjashme per nje objekt te vetem . Pjese e ketij procesverbali jane dhe fotot (6 cope) per te vertetuar kete fakt*)

- Nuk ploteson kriterin mbi drejtuesit e makinerive te renda, sipas Urdher Nr. 44 date 04.02.2004, pasi nuk ploteson numrin e manovratoreve te kerkuar per kete procedure prokurimi.
- Nuk ploteson kriterin mbi Inxhinierin e Certifikuar per Eficencen e Energjise, pasi nuk figuron ne listepagese per 6 muaj, sipas kerkeses per kualifikim pra eshte pa eksperiencen e kerkuar.

3) Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor “COMPANY RIVIERA 2008” shpk Kamez, Tirane kishte mangësi të dokumentave ligjore.

Mangësitë në dokumentacion te “COMPANY RIVIERA 2008” shpk Kamez,Tirane,janë si më poshtë:

- Nuk ploteson kriterin mbi numrin mesatar te punonjesve te kerkuar per periudhen mars 2015 - mars 2016 pasi per kete periudhe ne baze te dokumentacionit te paraqitur ka nje punesim mesatar prej 70.9 punonjesish nderkohe per te njejten periudhe jane kerkuar 30 punonjes ne objektin “Rikonstruksion i rruges Gani Banaj” per te cilen keni lidhur kontrate me Bashkine Patos. Pra, nje pjese e punonjesve jane te angazhuar ne nje kontrate te lidhur me Bashkine Patos.
- Nuk ploteson kriterin mbi "Inxhinierin e Certifikuar per Eficencen e Energjise", pasi edhe pse inxhinierja e paraqitur Eva Bezati figuron ne listepagese per me shume se 6 muaj, eshte pajisur me nje **certifikat trajnimi** (4 ditor) me date leshimi 02.05.2016, gje qe ben qe te mos plotesoj as kualifikimin e duhur dhe as eksperiencen e nevojshme (6 muaj)
- Nuk ploteson as kriterin mbi manovratoret e kerkuar per kete procedure prokurimi ne zbatim te vendimit nr .44 date 04.02.2004.

*(Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi mjetet per kete procedure ky operator ka mjete te cilat jane paraqitur edhe ne proceduren me objekt “ **Rikonstruksion i rruges Ruzhdije Gjinoqar**” per te cilen eshte shpallur oferta e kualifikuar dhe me vleren me te ulet por per shkak te ankesave per kete procedure nuk eshte shpallur njoftim i fituesit. Per kete arsye KVO-ja nuk mund ti quaj te angazhuara mjete ne kontrate tjeter por rezervon te drejten ne respektim te afateve ligjore te shpalljes se fituesit per kete procedure dhe afateve ligjore te shqyrtimit te ankesave per proceduren “Rikonstruksion i rruges Ruzhdije Gjinoqar te bej rivleresim procedure duke shtuar dhe kete kriter si kriter s'kualifikimi).*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine“**ED KONSTRUKSION**”sh.p.k Tirane me nr.Nipti K61625001I ne kontrate bashkepunimi me “**FUSHA**” sh.p.k Tirane me nr.Nipt-i J61922018S & “**ARKONSTUDIO**” sh.p.k Tirane me nr.Nipt-i L42019004I se oferta e paraqitur, me një vlerë oferte prej 80,238,055 (tetedhjetë milion e dyqind e tridhjetë e tete mije e pesedhjetë e pese) leke pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos sigurimin e kontratës dhe dokumentat origjinale, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 10 (dhjete) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura do të anulohet sikurse është e parashikuar në ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **15/06/2016.**

Ankesa: ka ose jo: **KA**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në date 24/06/2016 ankesa e shoqerise B-93”shpk Fier nga Bashkia Patos.

Me date 24/08/2016 prane Bashkise Patos eshte paraqitur Vendimi i Komisionit te Prokurimit Publik mbi ankesen e shoqerise B-93’shpk Fier.

TITULLARE E AUTORITETIT KONTRAKTOR

Rajmonda BALILAJ

